



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izbori Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.251/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdë Haziri kryesues, Afiete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarës së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me të mitur, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa ZL.Anr.251/2017 e datës 18.10.2017 e parashtruar nga Instituti për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

A r s y e t i m

Me datën 18.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe Internews Kosova, me të cilën pretendon se me datën 17.10.2017, rreth orës 16:10, kandidati për kryetar të Komunës së Suharekës Bali Muharremaj nga radhët e subjektit politik AAK, ka postuar fotografi në rrjetin social Facebook, lidhur me rastin e vizitës së tij në një çerdhe në Suharekë, ku janë përfshirë fëmijë të mitur.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se është shkelur nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së. (Rregulla nr. 13/2013).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur shtatë fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 19.10.2017, subjekti politik (AAK), deklaroi se kandidati për kryetar të Komunës së Suharekës Bali Muharremaj ka bërë një vizitë në njërin prej çerdheve të kësaj komune për të nga afër kushtet në të cilat trajtohen këta fëmijë dhe se këta fëmijë nuk janë shfrytëzuar për të bërë fushatë zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

2008

•